

mijëve në transmetim
e Autoritetit të M
që prej muajit prill k
më Buletini i shum
dime Këshillit të p
ave kanë Ankesave.
rejtë të kërkojë, të he
arrë dhe të ndajë inf
ide, pa asnjë lloj cen
, tu dhe mjeteve të tj
it audioviziv apo nd
tër bazuar në përzgje
se këtë e bën në kua
t të sundim
të njeriut.
krëjim in e shërbimev



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 6



GIUŠHT 2020

© AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



AMM **AUTORITÀ
MEDIAE
AUDIOVISIVE**

Dürmbajtje

A decorative graphic consisting of two red lines. One line starts at the bottom left, goes diagonally up to the right, then horizontally to the right, and then diagonally down to the right. The second line starts at the bottom left, goes diagonally up to the right, and then vertically down to the right. The two lines meet at a point on the right side, creating a large, open, stylized shape.

Në vend të hyrjes 7

SEKSIONI 1

Ankesa me subjekt "Cenim i rregullave të etikës dhe dinjitetit" 8

SEKSIONI II

Ankesa me subjekt "Cenim i të drejtave të fëmijëve". 26

SEKSIONI III

Ankesa me subjekt "Komunikime tregtare të ndaluara 34

SEKSIONI IV

Ankesa me objekt të ndryshëm..... 38

SEKSIONI V

Ankesa të rrëzuara..... 42

Në vend të hyrjes

The page features a dark gray background with a white header bar at the top. The number '6' is centered in the header. Below the header, the text 'Në vend të hyrjes' is written in a white, cursive script. The lower half of the page is dominated by a large, abstract geometric shape formed by two white lines. One line starts from the bottom left corner and extends diagonally upwards to the right. The second line starts from the bottom left, extends diagonally upwards to the right, but at a shallower angle than the first line, meeting it at a point. From this intersection point, a vertical white line extends upwards to the top edge of the page. The top edge of the page is a solid white line.

Buletini nr. 6 i Këshillit të Ankesave, si pjesë e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vjen me një përmbajtje të shtuar të punës së Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Periodha e parë e vitit 2019 iu dedikua në veçanti përmbajtjes së reklamave për të cilat ka një qasje mjaft komplekse për mënyrën e trajtimit të tyre.

Ligji për mediat audiovizive dhe rregullorja e AMA-s për reklamën detajon disa prej kërkesave kryesore të rregullimit të tyre në raport me hapësirën televizive. Përtej kësaj, çështja e përmbajtjes së tyre kërkon një vëmendje të shtuar, jo vetëm si detyrim për kërkesat ligjore, por edhe për të vështuar përmbajtjen e tyre si pjesë e rëndësishme e kulturës që transmeton reklama në shoqëri.

Për disa prej emisioneve më të ndjekura audiovizive, Këshilli i Ankesave ka iniciuar shqyrtimin e disa reklamave të fshehura, por edhe më tej, me reklamim shërbimesh, si ato shëndetësore, që prekin kodet e etikës së vetë mjekësisë.

Konkretisht, në këtë Buletin, gjendet konkluzioni i Këshillit të Ankesave në raport me këto reklama për mosrespektimin e kërkesave ligjore në transmetimin e reklamave dhe komunikimeve tregtare.

Një tjetër precedent i krijuar nga Këshilli i Ankesave ka të bëjë me reklamën e fshehtë, të palejuar në përmbajtjen audiovizive e, në veçanti, në programe informative dhe argëtuese. Paraqitja e produkteve apo shërbimeve të caktuara brenda një përmbajtjeje audiovizive është cilësuar e palejueshme dhe, për këtë, Këshilli i Ankesave ka kërkuar ndalimin e tyre.

Një nga përkufizimet më të rëndësishme në ligj përcakton se *“komunikim i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare”* është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërimit, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrojë publikun mbi natyrën e tij.. Në këtë kuptim, Këshilli i Ankesave ka monitoruar dhe vetëincur disa vendime penalizimi të përmbajtjeve audiovizive.

Por në këtë Buletin do të gjeni dhe shqyrtimin dhe konkluzionet e Këshillit të Ankesave për dhjetëra ankesa të tjera, me objekt cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit apo cenimi i të drejtave të fëmijëve.

Seksioni



ANKESA ME SUBJEKT

**“CENIM I
RREGULLAVE
TË ETIKËS
DHE DINJITETIT”**

Ankesa e paraqitur nga: **Një grup organizatash që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të vajzave dhe grave**

Subjekti audioviziv

"Top Channel"

Programi

"Dua të të bëj të lumtur"

Data

17.01.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se gjatë transmetimit të programit "Dua të të bëj të lumtur" është përshkruar në mënyrë të detajuar historia e një gruaje, viktimë e dhunës në familje në mënyrë të tillë që legjitimon ushtrimin e dhunës me bazë gjinore duke u bërë faktor në riaktivizimin e vajzave dhe grave të dhunuara.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi materialin përkatës filmik, konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.

Rrëfimi i zonzës, e cila pranon dhunën e ushtruar ndaj saj nga bashkëshorti, duke e toleruar dhe justifikuar atë, legjitimon ushtrimin e dhunës me bazë gjinore, duke shkelur në këtë mënyrë parimet e sanksionuara nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit.

Në nenin 4, pika d), ligji përcakton se "operatorët e shërbimit audioviziv,

gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga... moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve".

Të njëjtin përcaktim ka edhe Kodi i Transmetimit, në Seksionin 1 të tij "Parimet themelore", pika 1.5: *"Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve".*

Këshilli i Ankesave risolli në vëmendje respektimin rigoroz të parimeve ligjore dhe etike gjatë transmetimit të materialeve, sidomos kur ato kanë në fokus fëmijë dhe viktime të dhunës me bazë gjinore apo të dhunës në familje, pasi shkelja e këtyre parimeve jo vetëm nxit riviktimizimin e vajzave dhe grave të dhunuara, por përforcon edhe stereotipet gjinore.

Bazuar samë sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv dhe e paralajmëroi për vendosjen e sanksioneve të parashikuara ligjore, në rast përsëritjeje të shkeljes së ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **D.V.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Top Channel"

"Dua të të bëj të lumtur"

22.01.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja pretendon se në emisionin "Dua të të bëj të lumtur", transmetuar në televizionin "Top Channel" është prezantuar një histori trilluese duke dhunuar privatësinë dhe cenuar dinjitetin e saj e të familjes. Sipas pretendimeve të ankueses, gjatë emisionit ajo është shfaqur me zë dhe figurë pa miratimin e saj, ndërsa është prekur edhe dinjiteti dhe imazhi i anëtarëve të tjerë të familjes.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e ankesës, duke i kërkuar subjektit audioviziv "Top Channel" të paraqesë pretendimet e veta. Referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave në "Top Channel" paraqitjen e pretendimeve të tyre për këtë rast.

Në kthimin e përgjigjes, "Top

Channel" pretendon se emisioni nuk ka shkelur privatësinë e askujt, pasi bazohet në rrëfimin e vetë znj.S.Sh (e ëma e ankueses), e cila ka nënshkruar një deklaratë për këtë rast.

Më pas, Këshilli i Ankesave i drejtoi një kërkesë për shprehje mendimi për rastin në fjalë edhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në përgjigjen e tij, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale citon se, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar: *"Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social*.

Duke e gjykuar rastin kompleks, gjatë procedurave të trajtimit të kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave, referuar nenit 52, pika 6 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar organizoi një seancë

dëgjimore mes palëve (pala ankuese dhe përfaqësues të televizionit "Top Channel") për të dëgjuar pretendimet e tyre përpara se të shpalleshin konkluzionet përfundimtare nga Këshilli.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive, gjatë rrëfimit të historisë personale nga znj.S.Sh., në programin "Dua të të bëj të lumtur", ku përfshihen ngjarje personale të jetës private të personave të tjerë, si dhe në publikimin e videos ku shfaqet me zë dhe figurë ankuesja D.V, pa miratimin e saj.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, pika 2, germa ç) kërkon që "Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private".

Neni 33 i këtij ligji, "Detyrimet e OSHMA-ve", përcakton:

1. Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet:

ç) "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut".

dh) "të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe".

Edhe Kodi i Transmetimit, në Seksionin 3 të tij, "E Drejta për Privatësi dhe Mbrojtjen e të Drejtave Personale", pika 3.1 përcakton se: "Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale".

Gjithashtu, po në këtë seksion, në pikën 3.6 u kërkohet OSHMA-ve "të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe direktivat e vendosura nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetareske, letrare apo artistike"

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen televizionit dhe e paralajmëroi për marrjen e sanksioneve, në rast përsëritjeje të shkeljes së ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **J.H.**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
"Top Channel"	Edicioni informativ	14.02.2019
"Klan" Tv	Edicioni Informativ	14.02.2019
"Report" Tv	Edicioni Informativ	14.02.2019

1. Përmbledhje e ankesës:

Ankuesja pretendon se televizionet "Top Channel", "Klan" dhe "Report" kanë transmetuar lajme të rreme dhe të pavërteta, duke cenuar rëndë dinjitetin dhe reputacionin e saj. Sipas ankueses, raportimet e publikuara nga mediat e mësipërme që e përshkruajnë atë si "person të vënë në pranga për abuzime me disa tenderë në Ministrinë e Drejtësisë" janë "të pavërteta, tendencioze dhe abuzive".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e ankesës, duke u kërkuar tre subjekteve audiovizive paraqitjen e pretendimeve lidhur me kronikat përkatëse të transmetuara prej tyre. Referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave të subjekteve audiovizive

përkatëse paraqitjen e pretendimeve të tyre për këtë rast.

Në përgjigjet e tyre dërguar AMA-s, televizionet "Top Channel", "Klan" dhe "Report" theksojnë se, kronikat e transmetuara nga redaksitë përkatëse bazohen në vendimin e Gjykatës së Tiranës dhe pretendimin e Prokurorisë.

Më pas, Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim pretendimet e operatorëve audiovizivë dhe analizoi me kujdes kronikat përkatëse të transmetuara prej tyre. Pas, shqyrtimit Këshilli i Ankesave çmoi se raportimet mediatike të subjekteve audiovizive të mësipërme janë profesionale, korrekte dhe brenda normave etike dhe ligjore. Ato janë të bazuara në një dokument zyrtar, në këtë rast të një vendimi të shpallur nga gjykata, pas kërkesës së Prokurorisë, citimi i të cilit gjithashtu konsiderohet korrekt.

Si përfundim, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe as të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr 228 datë 11.12.2017.

Ankesa e paraqitur nga: **Disa individë**

Subjekti audioviziv

"Ora News"

Programi

"Ju flet Moska"

Data

21.03.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave mori disa ankesa për emisionin "Ju flet Moska", transmetuar në televizionin "Ora News" ku moderatori trajton ngjarjen e ndodhur në Zelandën e Re, ku një person i konsideruar ekstremist vrau qytetarë të pafajshëm, për shkak të bindjeve të tyre fetare. Ankuesit pretendojnë se gjuha dhe argumentet e përdorura nga moderatori i emisionit "përbëjnë nxitje të hapur të akteve të terrorit ndaj besimtarëve myslimanë dhe konflikt civil".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim materialin filmik të emisionit në fjalë dhe konstatoi se, komentet e moderatorit lidhur me ngjarjen e ndodhur në Zelandën e Re, ku një person i konsideruar ekstremist vrau qytetarë të pafajshëm për shkak të bindjeve të tyre fetare, shkelin ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Pavarësisht nga fakti se ku ka ndodhur ngjarja e komentuar (Zelanda e Re), nga drejtuesi i emisionit deklarime të tilla nxisin dhunë, intolerancë dhe urrejtje fetare.

Neni 4 pika 2 e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar sanksionon:

"Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime:

d) moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve;

dhe) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën.

Edhe pika 4 e nenit 32 të ligjit, përcakton detyrimin për operatorët audiovizivë që mos të transmetojnë

programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtarë dhe çdo forme tjetër diskriminimi.

Gjithashtu edhe neni 33 i ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyron OSHMA-të:

a) *të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive:*

b) *të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme;*

c) *t’i kushtojë hapësirën e nevojshme në transmetim çështjeve të aktualitetit lokal;*

ç) *të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;*

d) *të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale”.*

Këshilli i Ankesave vlerësoi se gjuha e përdorur në emisionin “Ju flet Moska”

është në shkelje të ligjit për mediat audiovizive, pasi nxiti intolerancën ndërmjet shtetasve, nxiti dhe justifikon dhunën, nuk respekton gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve. Shkelja e këtyre parimeve ligjore gjatë këtij transmetimi përbën nxitje të urrejtjes mbi baza fetare dhe, si e tillë, është e dënueshme nga ligji.

Sa më sipër, dhe duke patur parasysh se “AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron... që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve” (neni 18, “Objektivat e veprimtarisë së AMA-s”), bazuar në nenin 133 të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1, a), Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s vendosjen e sanksionit gjobë në masën 400.000 (katërqind mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv “Ora News”, ndalimin e ritransmetimit të emisionit “Ju flet Moska”, si dhe detyrimin e operatorit për heqjen e videos përkatëse nga kanali i tij zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **M.D.**

Subjekti audioviziv

"Fax News"

Programi

"Ajsberg"

Data

13.03.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasja M.D. pretendon se në emisionin "Ajsberg" që transmetohet në televizionin "Fax News" "është prekur nderi dhe dinjteti i saj dhe i familjes nga paraqitja e të vërtetave si falsifikime dhe i falsifikimeve si të vërteta". Ankuesja pretendon gjithashtu se janë paraqitur si të falsifikuara dokumentet e saj të pronësisë, të nxjerra nga organet kompetente shtetërore.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të materialit përkatës filmik, konstatoi se raportimi i rastit në fjalë është bazuar mbi dokumente të strukturave përkatëse shtetërore, në këtë rast të Arkivit të Shtetit, por edhe mbi dokumente noteriale. Gjatë investigimit të kësaj çështjeje nga emisioni ka patur vetëm renditje dokumentesh, prononcime etj, por nuk u konstatua cenim i parimeve ligjore dhe etike.

Këshilli i Ankesave, i cili nuk vërejtí shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit, nuk ka tagër të shprehet mbi vërtetësinë e dokumenteve që paraqiten në një emision televiziv.

Ankesa e paraqitur nga: **N.Ç.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Top Channel"

Emisioni informativ

18.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se disa kronika të transmetuara nga "Top Channel" *"janë në vazhden e lajmeve dhe akuzave të paprincipita dhe të pavërteta që ky kanal i bën personin tim dhe kompanisë që unë drejtoj"*.

Sipas ankuesit, televizioni ka shpifur në disa kronika lajmesh rreth një transaksioni tregtar, ndaj kërkoi ndalimin e transmetimeve, duke i cilësuar ato si "prekje e dinjitetit dhe reputacionit tim, si dhe të kompanisë që unë drejtoj".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave filloi shqyrtimin e saj dhe i kërkoi zyrtarisht subjektit audioviziv paraqitjen e pretendimeve ndaj ankesës së ardhur.

Kërkesa u bazua në nenin 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv".

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialet përkatëse filmike dhe pretendimet e Bordit të Shqyrtimit të Ankesave në "Top Channel", sipas të cilit, "Top Channel nuk ka pasqyruar asnjë qëndrim të tij" dhe se "i kemi kërkuar mundësinë ankuesit të shprehet për gjetjet investigative, por ai ka refuzuar duke lëshuar lumë fyerjesh publike ndaj medias tonë, ashtu si edhe e ribën këtë akuzë edhe në ankesën e tij drejtuar Autoritetit".

Në përfundim të këtij procesi, Këshilli i Ankesave vlerësoi se informacioni i transmetuar është i mbështetur në dokumente zyrtare dhe në deklaratimet e drejtpërdrejta e publike të një personi, i cili përfaqëson një palë në konflikt. Televizioni ka pasqyruar faktin se, çështja në fokus të kronikës është pjesë e një procesi gjyqësor dhe ka respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Raportimi i rastit ka qenë korrekt, profesional, brenda normave ligjore dhe parimeve etike. Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe as të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **I.L.**

Subjekti audioviziv

"Report" Tv

Programi

"Dosja K"

Data

19.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi I.L. pretendon se gjatë emisionit "Dosja K", transmetuar në "Report" Tv ishte përmendur emri i tij "për të keq", në lidhje me një historik të shkuar të persekutimit komunist. Sipas ankuesit, transmetimi e ka prekur atë personalisht, pasi sipas tij, kjo çështje ishte e rëndësishme për reputacionin personal, ndaj ai kërkoi ndërhyrjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave filloi shqyrtimin e saj dhe i kërkoi zyrtarisht subjektit audioviziv paraqitjen e pretendimeve ndaj ankesës së ardhur, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv".

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe pretendimeve që subjekti audioviziv depozitoi në AMA, Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit të transmetojë pretendimet e shtetasit I.L., referuar pikës nr 1, neni 13 i Rregullores "Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes", dhe në ushtrimin e të drejtës së përgjigjes për ankuesin, ajo duhet të transmetohet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Ankesa e paraqitur nga: **N.Ç.**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

Të gjitha

Edicionet informative

01.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasja M.B., bashkëshortja e të ndjerit A.B., i vrarë me armë zjarri më datë 30.01.2019, në Tiranë. Sipas ankesës, pamjet e ekzekutimit të shtetasit A.B., të transmetuara në mënyrë të përsëritur nga operatorët audiovizivë, përfshirë dhe operatorët kombëtarë, kanë shkaktuar stres tek bashkëshortja, familjarët e të ndjerit, por në veçanti, tek dy fëmijët e mitur të çiftit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi pamjet filmike përkatëse dhe transmetimet e deritanishme nga operatorët audiovizivë gjatë edicioneve informative, por jo vetëm, konstatoi se përmbajtja e tyre është e rëndë, e ndjeshme dhe private. Transmetimi i tyre është në shkelje të normave ligjore dhe etike.

Autoriteti i Mediave Audiovizive u kujton OSHMA-ve parimet themelore të veprimtarisë së tyre: “... *veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve*” (neni 4, pika 1/b, ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar).

Gjithashtu, edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive detyron OSHMA-të të respektojnë të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale: “*Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për*

jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkeluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale...” (Seksioni 3, “E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale”, pika 3.1).

Transmetimi i pamjeve filmike të vrasjes së shtetasit A.B. ka shkaktuar ankth dhe tronditje të thellë psikologjike, në veçanti, tek dy fëmijët e mitur të familjes së ankueses, të cilët po përjetojnë situata traumatizuese, që dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të tyre. Ndaj, Autoriteti i Mediave Audiovizive u kërkoi operatorëve ndërprerjen e menjëhershme të transmetimit të pamjeve filmike të vrasjes së shtetasit A.B.

Ankesa e paraqitur nga: **Nga individë**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Klan" Tv

"E diela shqiptare"

03.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë për rubrikën "Shihemi në gjyq", pjesë e emisionit "E diela shqiptare", që transmetohet në televizionin tuaj. Sipas ankesës, në rubrikën e transmetuar në datën 26.05.2019 ka shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, "pasi kishte fjalor dhe skena të një tentative për dhunimin e një gruaje".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim rubrikën në fjalë dhe konstatoi se, përgjatë emisionit, ku protagonistë janë një çift në konflikt për çështje pronësie, shfaqen disa skena të nxitjes së dhunës. Pas disa kërcënimeve verbale të bashkëshortit ndaj gruas së tij ("pusho" dhe "qepe gojën" etj), ka një tentativë për ta goditur atë (gruan) me shishen e ujit, dhe më pas, një tjetër përpjekje për konfrontim fizik mes bashkëshortëve, që parandalohet nga drejtuesi i emisionit.

Këshilli i Ankesave çmoi se, fjalori jo-etik i përdorur gjatë emisionit dhe tentativat për agresion dhe dhunë janë në shkelje të parimeve ligjore dhe etike për transmetimet audiovizive. Neni 4, pika 2, i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", sanksionon se:

"Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime:

d) moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve;

dh) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën".

Këshilli i Ankesave i kujtoi operatorit audioviziv se, emisioni transmetohet në një orar që ndiqet edhe nga të mitur, ndaj i kërkoi marrjen e masave për të shmangur materiale dhe situata që dëmtojnë të miturit, sipas kërkesave të Kodit të Transmetimit të AMA-s.

Neni 46, pika 2, germa dh) e ligjit nr. 97/2013 parashikon se *“Kodi i Transmetimit siguron që: në çështjet që përfshijnë moralin dhe etikën në materialet programore, veçanërisht paraqitja e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale të realizohet me kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve”*.

Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit korrektimin/redaktimin e materialeve, në rastet kur programet janë të regjistruara, në funksion të zbatimit të ligjit nr. 97/2013 dhe të Kodit të Transmetimit, si dhe i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv për të mos përsëritur raste të tilla.

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi A.T.**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

"Klan" Tv

Emisioni "Stop"

16.04.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.T., i cili pretendon se gjatë emisioni "Stop" në televizionin "Klan" është trajtuar një çështje gjyqësore, duke i përmendur emrin e tij. Ankuesi pretendon se emisioni "është treguar i njëanshëm duke deformuar dhe keqinformuar çështjen e trajtuar".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi u njoh me kërkesën e ankuesit, iu drejtua televizionit "Klan" me një kërkesë për t'i dhënë mundësi ankuesit të paraqesë pretendimet e tij. Bazuar në nenin 33, pika 1, gërma b, të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "OSHMA duhet të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme". Gjithashtu, edhe Kodi i Transmetimit, në Seksionin 4, garanton që "Informacioni i transmetuar duhet të jetë i vërtetë, i saktë, i balancuar dhe i verifikuar".

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi E.C.**

Subjekti audioviziv

"Klan" Tv

Programi

"Opinion"

Data

15.05.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi E.C. u ankua se gjatë emisionit "Opinion", që transmetohet në televizionin "Klan", një nga të ftuarit përdori fjalë fyese dhe diskriminuese, si *"morëm një karrocë me një jevg"*, duke përshkruar një ngjarje të kaluar. Ankuesi kërkoi ndërhyrjen e AMA-s ndaj televizionit dhe emisionit për të "reaguar ndaj kësaj fyerje diskriminuese, që prek një komunitet të gjerë në shoqëri".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e mori në konsideratë këtë kërkesë dhe këqyri materialet video të transmetimit të emisionit. Gjatë bisedës në studio, një prej të ftuarve përdori shprehjen: *"morëm një karrocë me një jevg"*. Në këtë moment, drejtuesi i emisionit ka ndërhyrë, duke i kërkuar të ftuarit të mos e përsërisë më atë shprehje.

Duke vlerësuar ndjeshmërinë për raste të tilla, si dhe duke vlerësuar faktin që emisioni ishte në transmetim të drejtpërdrejtë, Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit "Klan" të bëjë kujdes në raste të ngjashme në të ardhmen dhe të korrektojë pjesën me shprehjen fyese. Televizioni reagoi në mënyrë të shpejtë, duke e hequr pjesën përkatëse në materialin e kaluar, në kanalën e tij zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi N.A.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Ora News" Tv

Emisioni "Boom"

10.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi M.A. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave, në Autoritetin e Mediave Audiovizive, përmes së cilës pretendoi shkelje të nenit 33, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nga emisioni "Boom", transmetuar në televizionin "Ora News", në datën 05.06.2019, ora 19:00. Sipas ankuesit, subjekti "Ora News" Tv nuk i është përgjigjur kërkesës së tij për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur pretendimet e tij.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, që detyron OSHMA-të të japin përgjigje mbi kërkesën e çdo subjekti të interesuar, i dërgoi një shkresë subjektir "Ora News" Tv mbi respektimin e të drejtës së përgjigjes. Në përgjigjen dërguar AMA-s, me shkresë nr.2404/1 Prot., datë 17.06.2019, Shoqëria "Ora" sh.a., vë në dukje se ajo çfarë është transmetuar në emisionin "Boom" të datës 05.06.2019, ora 19:00,

bazohet në dokumente ligjore, të dhëna zyrtare, si dhe në dëshmitë e artistëve mbi zbatimin e ligjit "Për të drejtën e autorit". Gjithashtu shoqëria "Ora" sh.a nënvizon se "emisioni 'Boom' ka bërë gjithë tratativat e mundshme për të pasur edhe një shpjegim/intervistë/përgjigje nga ana juaj (ankuesit), gjë e cila është refuzuar".

Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit me kujdes të emisionit investigativ "Boom" të datës 05.06.2019 ora 19:00, nuk konstatoi shkelje të nenit 33 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe as të Kodit të Transmetimit. Raportimi i rastit në fjalë ka qenë korrekt dhe i drejtë për të gjithë subjektet e interesuar dhe është bazuar mbi dokumente ligjore e zyrtare, si dhe mbi deklaratat e realizuara me zë dhe figurë të artistëve të intervistuar.

Seksioni

2

ANKESA ME SUBJEKT

“CENIM I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi E.C.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Ora News"

Edicioni informativ

28.01.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve u ankua për shkelje të privatësisë të fëmijëve jetimë në një fshat të bashkisë Maliq, të cilët ishin intervistuar, gjatë një kronike informative, transmetuar nga televizioni "Ora News". Ankuesi pretendon se fëmijët të mbetur jetimë pas vdekjes së babait të tyre u intervistuan pa marrë parasysh privatësinë dhe ruajtjen e kofidencialitetit të fëmijëve.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim kronikën e transmetuar nga televizioni "Ora News", ku paraqiten katër vëllezër jetimë, në varfëri të tejskajshme ekonomike, dhe konstatoi se transmetimi përbën interes publik për të sensibilizuar opinionin dhe institucionet për të vepruar në dobi të fëmijëve, të cilët kërkojnë ndihmë për mbijetesë.

AMA dhe Këshilli i Ankesave ndjek me rigorozitet çdo ankesë për cenim/shkelje të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të parimeve e rregullave që përmban Kodi i Transmetimit. Konkretisht, në Kodin e Transmetimit,

Seksioni 3, pika 3.1 thuhet: *"Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standartet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale. Përfshirja në jetën publike nuk i përjashton individët nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanat e këtyre mund të ndikojnë në performancën e tyre ose në përshtatjen me rolet publike që mbajnë ose kërkojnë".*

Këshilli i Ankesave çmoi se, transmetimi i rastit të katër fëmijëve jetimë përbën interes publik, duke e tejkaluar të drejtën e tyre për privatësi në dobi të vetë fëmijëve.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Report" Tv

"Pa Gjurmë"

29.01.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pretendon se, në emisionin "Pa Gjurmë", të transmetuar në televizionin "Report" janë dhunuar të drejtat e një fëmije, duke cenuar privatësinë dhe dinjitetin e tij. Emisioni "Pa gjurmë" trajtoi historinë e një gruaje të zhdukur, e cila mendohet se mund të jetë trafikuar. Në studio ndodhen dy prindërit e saj, të cilët pretendojnë se djali i braktisur nga vajza e tyre, ka gjetur vendndodhjen e saj përmes internetit. Sipas ankuesit, i mituri 6 vjeç ftohet në transmetim direkt dhe intervistohet i pambuluar, i identifikuar me emër, i pyetur në mënyrë të papërshtatshme nga moderatorja. Gjatë intervistimit, i mituri duket se është në gjendje të rënduar psikologjike, teksa në ekranin përballë tij shfaqeshin fotot e pretenduara të ëmës së tij, foto me përmbajtje seksuale. Fëmijës i kërkohet të tregojë se si ka zbuluar fotot e nënës në internet, e cila besohet se mund të jetë trafikuar në Britaninë e Madhe.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave kërkoi nga "Report" Tv paraqitjen e pretendimeve të tij për rastin, gjë që nuk e respektua nga operatori audioviziv, i cili nuk depozitoi pretendimet e tij në zyrën e Protokollit të AMA-s, ashtu siç i kërkohet në shkresën përcjellëse të sipërcituar. Më pas Këshilli i Ankesave vijoi me shqyrtimin e materialit dhe konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sanksionon detyrimin që, në transmetimet e tyre mediat audiovizive të ruajnë konfidencialitetin dhe të respektojnë privatësinë e fëmijës.

Neni 33 i këtij ligji, "Detyrimet e OSHMA-ve", përcakton:

1. *Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet:*

ç) të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut".

Kodi i Transmetimit, në Seksionin 5 të tij, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", sanksionon: "Të dhënat e

publikuara për fëmijët në media duhet të shmangin: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, apo të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e fëmijës; rrethana, detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cenojnë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit publik; emër shkollë, kopshti, institucioni në rastet kur situata e abuzimit apo veprës penale nuk kanë ndodhur në institucion; emrin e autorit të krimit, i cili ka marrëdhënie gjaku me viktimën” (pika 5.4).

“OSHMA-ve u ndalohej transmetimi i pamjeve të fëmijëve me nuancë seksuale apo që paraqet fëmijën në pozicione të papërshtatshme; duhet të shmangin transmetimin e pamjeve të fëmijëve në situata dhe mjedise që përcjellin mesazhe denigruese, kur fëmija është i identifikueshëm” (pika 5.8).

“Në rast se gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për fakte, bërra publike e të cilave mund të rrezikojnë jetën, shëndetin, arsimimin, mirëqenien fizike, emocionale, morale të fëmijës, intervista apo pjesë e saj nuk duhet të transmetohet” (pika 5.19).

Sa më sipër, bazuar në nenin 133 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1, germa a), Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s vendosjen e sanksionit gjobë në masën 200.000 (dyqind mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv “Report” Tv, si dhe detyrimin e operatorit për heqjen e videos përkatëse nga kanali i tij zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Klan" Tv

"Rudina"

27.03.2019

1. Përmbledhje

Në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të përmbajtjeve të emetuara nga OSHMA-të, bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit të Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, të datës 11.01.2019, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s evidentoi se, në programin "Rudina", që transmetohet në televizionin kombëtar "Klan", nuk janë respektuar kërkesat për reklamat dhe komunikimet tregtare. Në fokus të programit ishin aspekte të kirurgjisë estetike dhe mënyrat e trajtimit në një poliklinikë private. Gjithashtu, në studio ishin të ftuar mjekë të poliklinikës dhe administratorja në cilësinë e mjekes specialiste, e cila prezantoi nëpërmjet inserteve shërbimet e klinikës.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes materialin filmik të emisionit "Rudina", transmetuar në televizionin "Klan" dhe konstatoi mosrespektim të kërkesave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në nenin 42, pika 1, përcaktohet se, *"komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të*

jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara". Është shkëlur po ashtu dhe neni 44, për "vendosjen e produkteve gjatë programeve".

Ndërkohë, që të intervistuarit kanë shkëlur dhe "Kodin e etikës dhe deontologjisë mjekësore", ku ndalohe për mjekun *"të merret me reklama a publicitet të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve kur këto kanë qëllim shkencor apo edukativ. Në këtë rast, mjeku duhet të bëjë kujdes që publiciteti të jetë objektiv dhe në përshtatje me rregullat e deontologjisë mjekësore. Mjekut nuk i lejohet të bëjë asnjë publicitet në favor të aktivitetit të tij personal, apo të një institucioni të caktuar"*, siç përcakton pika 3 e nenit 60.

Duke marrë në konsideratë faktin se programit "Rudina" në televizionin kombëtar "Klan" i është tërhequr edhe më parë vëmendja, po për mosrespektimin e kërkesave ligjore në transmetimin e reklamave dhe komunikimeve tregtare, ku në fokus kanë qenë institucione shëndetësore private, Këshilli i Ankesave i propozoi Bordit të AMA-s vendosjen e sanksionit gjorbë ndaj subjektit audioviziv Tv "Klan", si dhe detyrimin e operatorit për heqjen e videos përkatëse nga kanali i tij zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi E.C.**

Subjekti audioviziv

"Top Channel"

Programi

"Portokalli"

Data

**10, 17, 24 mars
2019**

1. Përmbledhje

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ka vëzhguar spektaklin e humorit "Portokalli", që transmetohet në televizionin "Top Channel" dhe ka evidentuar transmetimin e komunikimeve tregtare të fshehta e të ndaluara. Më konkretisht, gjatë spektaklit "Portokalli", aktorët e humorit reklamojnë birrën "Peja", duke e shoqëruar me shprehje promovuese "... siç është bërë zakon, gëzuar me birrën 'Peja', që është më e mira", etj.

2. Konkluzionet e Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të materialit filmik të spektaklit "Portokalli", konstatoi shkelje të ligjit 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Neni 3, pika 7 e ligjit të sipërcituar përcakton se *"komunikim i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare"* është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërimit, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrojë publikun mbi natyrën e tij...".

Këto lloj komunikimesh janë në kundërshtim me nenin 42, pika 1, ku përcaktohet se *"komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara"*.

Bazuar samë sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen televizionit dhe e paralajmëroi për marrjen e sanksioneve sipas ligjit në rast përsëritjeje të shkeljes së ligjit për mediat audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

Të gjitha

Emisioni informativ

25.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve kërkon heqjen e një materiali video nga kanali zyrtar në Youtube të një kronike informative të transmetuar më herët, ku subjekt është një e mitur. Agjencia pretendon se, prania e materialit video mbetet shqetësim për të miturën, e cila ndodhet në një periudhë rehabilitimi dhe ekspozimi i videos e vendoste në rrezik shëndetin dhe mirëqenien e saj.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në konsideratë këtë kërkesë të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe, duke marrë parasysh se e mitura, e konsideruar fëmijë në nevojë, po integrohet përmes bashkëpunimit të Agjencisë, si dhe duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, u kërkoi operatorëve audiovizivë heqjen e materialit video nga kanali i tyre zyrtar në Youtube, me qëllim ndihmesën dhe rehabilitimin sa më të shpejte të së miturës.

Seksioni

3

ANKESA ME SUBJEKT

“KOMUNIKIME TREGTARE TË NDALUARA”

Ankesa e paraqitur nga: **Nga individë**

Subjekti audioviziv

"News 24"

Programi

"Dritare me Rudinën"

Data

03.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori ankesë ndaj emisionit "Dritare me Rudinën", që transmetohet në televizionin "News 24". Ankuesi pretendon se, në emisionin e datës 21.05.2019, me temën "Dua të pushoj në Shqipëri", ka shkelje të ligjit për mediat audiovizive, më konkretisht të kërkesave për komunikimet tregtare.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi emisionin në fjalë dhe konstatoi se nuk janë respektuar kërkesat për reklamën dhe komunikimet tregtare. Pavarësisht temës së trajtuar, një temë e ndjeshme në prag të sezonit turistik dhe për këtë duhet përgëzuar televizioni dhe drejtuesja e emisionit, nuk duhen shkelur në asnjë rast kërkesat e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për reklamën dhe komunikimet tregtare.

Në emisionin e kësaj date konstatohet reklamë e fshehur.

Në një moment të emisionit, teksa flet një nga të ftuarit në studio, kryetari i Bashkisë së Kavajës, drejtuesja e emisionit ndërhy, duke i kërkuar atij të përsërisë atë që i ka thënë (sipas drejtueses së emisionit) gjatë ndërprerjes publicitare. "Hoteli më i bukur në Shqipëri është në zonën time", shprehet drejtuesja, duke lënë

të kuptohet se këtë ia ka thënë kryetar i Bashkisë, i ftuar në emision. Më pas, drejtuesja shton: "Tek 'Prestige Resort...' dhe më tej, pas një ndërhyrjeje tjetër të të ftuarve, drejtuesja shton sërish: "...resorti më i bukur, se e zvogëlova..."

Këto shprehje konsiderohen komunikime me natyrë tregtare të fshehur, bazuar në nenin 3, "Përkufizime", pika 7 e ligjit 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se "komunikimi i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare" është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërimit, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrojë publikun mbi natyrën e tij..."

Këto lloj komunikimesh janë në kundërshtim me nenin 42, pika 1, sipas së cilës, "komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara".

Sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv për ndërprerjen e praktikave me komunikime tregtare të fshehura, pasi përsëritja do të shoqërohet me fillimin e procedimit, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi F.V.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"Top Channel"

Emisioni "Hipokrati"

17.01.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja F.V. pretendonte se gjatë emisionit "Hipokrati", i cili trajtoi një temë mbi kujdesin, ushqyerjen dhe fazat e zhvillimit të foshnjave dhe të porsalindurve, është paraqitur një reklamë e qumështit "Aptamil", duke nxitur ushqyerjen e foshnjave me qumësht formule që zëvendësojnë qumështin e gjirit. Sipas ankueses, sa më sipër përbën një komunikim tregtar të fshehur në shkelje të ligjit për mediat audiovizive.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të materialit filmik, konstatoi se reklama e paraqitur nga moderatorja e emisionit për qumështin e formulës "Aptamil" përbën një komunikim tregtar të fshehtë, të ndaluar me ligj. Referuar ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, komunikimet tregtare me natyrë të fshehur janë të ndaluara. Konkretisht, neni 42, pika 1 e ligjit parashikon se "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla.

Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara".

Neni 46, pika 2, i Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar parashikon se: "Kodi i transmetimit siguron që "reklamat, shitjet e drejtpërdrejta, materialet e shitjeve të drejtpërdrejta, sponsorizimet dhe format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, veçanërisht ato që lidhen me çështje që mund të jenë drejtpërsëdrejti ose jo në interes të të miturve, duhet të ruajnë interesin e tyre, duke pasur kujdes të veçantë për shëndetin e tyre". Ky detyrim përcaktohet po ashtu edhe në Kodin e Transmetimit për median audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 221, datë 01.12.2017, në seksionin për reklamat dhe fëmijët. Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen televizionit për të mos përsëritur raste të ngjashme, që bien ndesh me kërkesat ligjore.

Seksioni

4

ANKESA ME SUBJEKT

ANKESA TË TJERA

Kërkesë e iniciuar

Ankesa e paraqitur nga: **Nga individë**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Televizionet kombëtare

"Gjuha e shenjave"

25.06.2019

1. Përmbledhje

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) u ka dërguar disa shkresa-kujtesë operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare: "Top Channel", "Klan" dhe "Vizion+". Kërkesa ka të bëjë me respektimin e kërkesave të ligjit për njerëzit me nevoja të veçanta.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Shkresat u janë dërguar në tetor 2017, nëntor 2018, qershor 2019. Ato bazohen në:

-nenin 3 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, seksioni "Përkufizime", pika 10, sipas të cilës: "Komunitet me nevoja të veçanta shqisore" është komuniteti me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit";

-nenin 32 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, seksioni

"Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive", pika 5, sipas së cilës: "Shërbimet e transmetimeve audiovizive marrin parasysh nevojat e personave me nevoja të veçanta shqisore";

-nenin 47 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, seksioni "Rregulloret e transmetimit", pika 2, germa a), sipas së cilës: "Rregulloret e transmetimit... duhet të përcaktojnë për çdo OSHMA sigurimin e shërbimeve të tilla si: a) gjuha e shenjave";

-nenin 67 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, seksioni "Licenca e shërbimit për programet audiovizive", pika 1 dhe 2, germa dh), sipas të cilave: "AMA jep licenca shërbimi për programet audiovizive, në bazë të së cilës i licencuari ka të drejtat dhe detyrime për të ngritur dhe realizuar një shërbim programi audioviziv. Në bazë të licencës, i licencuari ka të drejtë për të ngritur, realizuar dhe vënë në funksion pajisje transmetuese, me qëllim transmetimin e shërbimit

të programit audioviziv. AMA siguron që shërbimi i programit audioviziv... të përfshijë, në mënyrë të arsyeshme përdorimin e gjuhës së shenjave në emisionet e lajmeve për njerëzit që nuk dëgjojnë”.

Bazuar sa më sipër, AMA u ka kujtuar operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare zbatimin e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi transmetimet për personat me nevoja të veçanta shqisore dhe marrjen e masave për konkretizimin e transmetimeve me bazë gjuhën e shenjave. operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare u është kërkuar të njoftojnë zyrtarisht Autoritetin për zbatimin e kësaj kërkesë ligjore.

Seksioni

5

ANKESA ME SUBJEKT

ANKESA TË RRËZUARA

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi M.G.J.**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasja M.Gj. ankohet në lidhje me një shkrim, shoqëruar me foton e saj, të botuar në një portal online.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Ankesa është jashtë kuadrit ligjor mbi të cilin bazohet veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Si e tillë, ankesa ishte jashtë objektit të punës së Autoritetit, e për rrjedhojë, edhe jashtë objektit të punës së Këshillit të Ankesave pranë AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasja H.Z.**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

"News 24"

Edicioni informativ

15.05.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori një ankesë nga shtetasja H.Z., e cila vuri në dijeni Këshillin e Ankesave lidhur me një kërkesë për televizionin "News" 24 për vënie në dispozicion të një materiali të regjistruar, konkretisht të një edicioni lajmesh.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi u njoh me kërkesën dhe afatet e saj, konstatoi se ajo është jashtë afateve ligjore. Konkretisht, në parashikimet e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 37 i këtij ligjit, 'Regjistrimi i transmetimeve', në pikën nr 1 përcakton se *"OSHMA-ja me mjetet e pajisjet e veta dhe në një mënyrë të përcaktuar për këtë qëllim nga AMA, duhet të mbajë katalogun e programeve dhe të regjistrojë çdo transmetim të ofruar prej tij, në përputhje me licencën"*. Në pikën nr 2 të këtij neni përcaktohet se *"Regjistrimet e bëra në përputhje me pikën 1 të këtij neni duhet të ruhen nga OSHMA-ja për një periudhë 3 mujore"*.

Në rast ankese, neni 52 i ligjit rregullon afatet ligjore të ruajtjes së transmetimeve. Konkretisht, pika 2 e këtij neni kërkon që *"ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga datat e transmetimit më të vonë"*.

MM



Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Kufia Postare 1010, Tiranë.

Cel: +355 67 303 3000

e-mail: Info@ama.gov.al

www.ama.gov.al